



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 98

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Prishtinë, më 16 prill 2014, në orën 14:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Faton Topalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Faik Hoti dhe Mentor Bislimi , përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë; Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit; Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 2.4.2014;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, para miratimit në parim;**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi propozoi që Projektligji për shëndetin mendor, të hiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në një mbledhje tjetër të radhës.

Komisioni e përkrahu njëzëri propozimin.

Salihe Mustafa, propozoi që në pikën të ndryshme, të diskutohet Ligji për produkte dhe pajisje medicinale, i cili është miratuar seancën e fundit.

Rendi i ditës u miratua me plotësimet e propozuara.

2 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 2.4.2014

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 2.4.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka – Si Komision, kemi punuar mjaft në këtë projektligj, i cili është vonuar mjaft nëpër komisionet tjera. Ne e kemi përcjellë për në seancë për miratim, ku seanca ka vendosur që të kthehet edhe një herë për shqyrtim në Komision. Si Komision, kemi shqyrtuar edhe një herë, ku kemi pasur disa mospajtime për disa nene, por kemi bërë vetëm një ndryshim të amendamenti 19 dhe e kemi proceduar në komisionet e përhershme, nga të cilat nuk kemi marrë ndonjë propozim-amendament. Atëherë, ne si Komision edhe një herë duhet të votojmë dhe ta procedojmë projektligjin për seancë, me qëllim që të hyjë në rend dite në seancën e radhës.

Faton Topalli – Tha se si VV, kemi deklaruar edhe në seancë se nuk e mbështesim këtë projektligj në këtë formë çfarë është, pasi që konsiderojmë se ky projektligj nuk siguron pensione përmbajtjesore, nuk siguron pensione të cilat sigurojnë një jetë me dinjitet të pensionistëve, andaj ne në këtë formë çfarë është ky projektligj, jemi krejtësisht kundër tij.

Time Kadriaj – Tha se si AAK, kemi potencuar qysh në fillim se nuk është projektligji më i mirë që vërtet i përmbush nevojat e pensionistëve, mirëpo si Komision, me amendamentet që i kemi propozuar, jemi munduar që ta kompletojmë sadopak. Është e vërtetë që ky projektligj është zvarritur mjaft shumë, por besoj se sot, si Komision, do të vendosim sesi do të veprojmë më tej.

Flora Brovina – Si PDK, e kemi përkrahur këtë projektligj prej fillimit dhe mosaprovimi i këtij projektligji është pengesë për shumë çështjeje për kategorizimin e pensionistëve në bazë të viteve të punës, në bazë të përgatitjes profesionale, shkollimit etj. Po ashtu, ky projektligj ka qenë pengesë edhe për lidhjen e marrëveshjeve ndërshtetërore për pensione. Prandaj, ky projektligj duhet të miratohet kështu siç është.

Salihe Mustafa – Edhe unë e përkrahu që ky projektligj të miratohet dhe mendoj se është pengesë mosmiratimi i tij për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet shteteve. Ky projektligj është e vërtetë se gati që dy vite po diskutohet në Komision. Është e vërtetë se nuk është projektligji më i mirë i mundshëm, por unë e përkrahu dhe jam që ta miratojmë si Komision dhe të shkojë në seancë për miratim.

Bahri Thaçi – Tha se ne si LDK, fuqimisht i përkrahim pensionistët, po ashtu edhe Projektligjin për pensionet, mirëpo ne nuk mund të heshtim ndaj njerëzve të cilëve po iu bëhet e padrejtë. Pra, njerëzit të cilët janë nxjerrë me dhunë nga puna prej viti 1989 deri në vitin 1999, pa baze ligjore, kështu që kërkojmë të rregullohet me këtë ligj statusi i këtyre personave, mirëpo për shkak të interesave apo rëndësisë, të cilat u përmendën për pensionistët, ne do ta përkrahim këtë projektligj.

Pas diskutimeve, Komisioni, me 8 vota për dhe një kundër, miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe kërkoi që të procedohet për miratim në seancë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, para miratimit në parim

Fikrim Damka – E dimë se ky ligj është miratuar kohëve të fundit dhe ende nuk i ka bërë një vit që është miratuar, mirëpo një nismë qytetare ka mbledhur mbi 10 000 nënshkrime, ku kërkojnë që të ndryshohet neni 9, paragrafi 2 i ligjit. Kryesia e Kuvendit e ka shqyrtuar këtë nismë dhe njëherit ka kërkuar nga Komisioni që ta shqyrtojë dhe të deklarohej se a e përkrahim. Sot, ne si Komision, po diskutojmë dhe do ta procedojmë më tej, varësisht se si do të vendosë Komisioni.

Time Kadriaj – Gjatë amendamentimit të këtij projektligji, si Komision e kemi mbështetur këtë amendament, mirëpo kur është votuar në seancë, nuk është përkrahur si i tillë. Mirëpo, prapë sot do ta shqyrtojë dhe do të vendosim për procedim të mëtejshëm.

Gëzim Kelmendi – Fillimisht, Projektligji për kontrollin e duhanit kur është sponsorizuar nga Ministria e Shëndetësisë e ka paraparë këtë ndalesë, ndërsa Komisioni gjatë fazës së amendamentimit ka votuar një amendament të ngjashëm me atë që ka ardhur tani si propozim nga nisma qytetare. Është e vërtetë se Komisioni e ka mbështetur këtë propozim, mirëpo seanca ka vendosur ndryshe dhe vendimi i seancës është më i fuqishëm sesa vendimi i Komisionit. Unë gjatë seancës, kur është votuar për këtë projektligj, kam deklaruar se neni 9, paragrafi 2, është në kundërshtim të plotë me shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës. Në këtë rast, ne si Komision për Shëndetësi nuk duhet në asnjë mënyrë që të legjitimojmë këtë nen, i cili është në kundërshtim me shëndetin publik për qytetarët e Kosovës. Do të jetë gabim shumë i madh që si Komision, të përkrahim këtë nen, i cili ndikon në shëndetin publik dhe në shitjen e pakontrolluar të produkteve të duhanit. Sponsorizuesit apo nisma për këtë ndryshim të këtij ligji, duhet të jenë të vetëdijshëm se Ligji për kontrollin e duhanit nuk e ndalon shitjen e duhanit, por e ndalon ekspozimin e tij. Ne kemi qenë në vizitë dhe nëse dëshirojmë t'i marrim praktikën e vendeve të BE-së, të cilat janë më të zhvilluara, duhet të marrim një hap më ndryshe, i cili do të ishte më i disfavorshëm për këtë propozim, ku dyqanet ushqimore dhe marketët nuk kanë të drejtë shitjen e duhanit, por janë dyqane të specializuara për duhan. Pra, ligji në fuqi, askënd nuk e ndalon të shesë duhan, por e ndalon ekspozimin e tij, prandaj po them që si Komision për Shëndetësi, nuk duhet të përkrahim këtë propozim, i cili është në kundërshtim me shëndetin publik të qytetarëve.

Faton Topalli – Mendoj se kërkesa e mbi 10 000 qytetarëve duhet të shqyrtohet. Ka grupe të ndryshme të interesit dhe është një çështje shumë e ndjeshme. Personalisht, mendoj se shitja e hapur është një ngacim direkt për të blerë duhanin dhe propozoj që para se të vendosim si Komision, të organizojmë një dëgjim publik me grupet e interesit dhe mandej të vendosim sesi ta procedojmë më tej.

Fikrim Damka – Tha se dëgjimi publik mbahet pas kalimit të projektligjit në leximin e parë, kurse para leximit të parë, Komisioni duhet ta shqyrtojë projektligjin dhe të japë rekomandimin e tij se a e përkrah në parim, kurse pasi të kalojë leximin e parë, ne mund të vendosim se a do të mbajmë dëgjim publik.

Faik Hoti –Tha se si Ministri, iu kemi përgjigjur me shkrim lidhur me nismën për ndryshimin e Ligjit për kontrollin e duhanit. Nisma për ndryshimin e këtij ligji ka filluar vetëm dy muaj pasi ligji ka hyrë në fuqi, pa e bërë një analizë të mirë pas një kohe të zbatimit të këtij ligji në praktikë dhe duke e analizuar mirë se a i dëmton subjektet afariste. Si Ministri, jemi deklaruar se për ne është i papranueshëm ndryshimi i këtij ligji, respektivisht neni 9, paragrafi 2. Ky ligj, mbi të gjitha mbron shëndetin publik të qytetarëve, i cili është i garantuar edhe me Kushtetutën e Kosovës, e assesi nuk i dëmton bizneset që merren me shitjen e duhanit. Të gjithë jemi dëshmitarë se mund të themi se është befasia më e mirë që neni 9, po respektohet nga të gjitha dyqanet, marketët dhe nuk kemi ekspozim të produkteve të duhanit. Është një periudhë shumë e shkurtër që ne të dalim me analiza se a e ka dëmtuar ekonominë e vendit ky ligj. Mendojmë se është e kundërta, se vetë ekspozimi i duhanit në pikat e shitjes është një lloj ngacmimi apo joshje e të rinjve për të filluar pirjen e duhanit. Jemi të vetëdijshëm se industria e duhanit është e interesuar që të këtë sa më shumë duhanpirës të rinj.

Si Ministri e Shëndetësisë, jemi kundër ndryshimit të Ligjit për kontrollin e duhanit, pasi që konsiderojmë se e dëmton shëndetin publik të qytetarëve dhe se gjatë monitorimit të zbatimit kemi vejtur se është duke u respektuar në pjesën më të madhe, dhe për çdo ditë po avancohet zbatimi i tij, jemi kundër ndryshimit.

Nazane Breca – Ju e dini se unë kam qenë kundër ekspozimit të duhanit në vendet e shitjes. Shpeshherë është thënë se po dëmtohen bizneset, si dhe duhanpirësit, mirëpo me sa po shihet, asnjëra palë s'po dëmtohet me këtë ligj. Ne i kemi mbrojtur ata qytetarë që s'e përdorin duhanin, si dhe fëmijët apo adoleshentet ku është kategoria më e atakuar, pasi që janë në fazën ku kureshtja e tyre mund t'i dërgojë deri tek provimi, si rezultat i ekspozimit të duhanit, pikërisht për të shuar kureshtjen që të fillojnë me pirjen e duhanit. Unë e kam vërejtur se kjo dispozitë mjaft mirë po zbatohet nëpër lokalet afariste, ku shumica e tyre kanë një mbishkrim : “Këtu shitet duhani” apo i kanë të mbuluar, vendosur në dollap të mbyllur dhe kur kërkon blerësi, vetëm hapet dhe mund të përzgjedhë llojin e duhanit dhe nuk besoj se i dëmton bizneset, përkundrazi mbrohen qytetarët që nuk e konsumojnë. Kështu që, nuk jam për të ndryshuar këtë nen, do të kishte qenë mirë që të pritet edhe një kohë dhe të bëhen analiza se sa i ka efektet e tij ky ligj apo ky nen, si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në shëndetin publik të qytetarëve. Ne si Komision, më tepër duhet të përkushtohemi në mbrojtjen e shëndetit publik, sidomos mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

Bahri Thaçi – Tha se e kemi një nismë që ka mbledhur 10 000 nënshkrime për ndryshimin e këtij ligji, mirëpo kemi pjesën tjetër me shumë më shumë qytetarë. Ne tash ballafaqohemi se a duhet t'i përkrahim kompanitë që merren me shitjen e duhanit apo t'i përkrahim ata që kemi obligim ligjor, por edhe moral në njëfarë mënyre, për të penguar rekrutimin e duhanpirësve të rinj. Besoj se edhe kompanitë e dinë mirë se ky ligj nuk e ndalon shitjen e duhanit, por e ndalon rekrutimin e duhanpirësve të rinj. Unë jam i sigurt se nuk ka rënie të shitjes së duhanit apo mund të jetë një përqindje e vogël. Edhe nëse ka rënie, kjo rënie është për arsye të studimeve dhe kampanjave, duhani dëmton seriozisht shëndetin, e jo për shkak se nuk lejohet ekspozimi i duhanit. Është sukses i madh për Komisionin se ky ligj të mbështetet që të zbatohet kështu siç është. Ne e dimë se ky ligj është votuar njëherë në seancë dhe seanca ka vendosur që të ketë ndalim të ekspozimit. Po ashtu, besoj shumë se çdo deputet që është i vullnetit të mirë, përsëri do të votojë njëjtë, pasi që nuk besoj se asnjëri nga ne, nuk është që të kemi duhanpirës të rinj. Jam kundër ndryshimit të këtij ligji, pasi që këtu janë përmendur disa shifra se sa ka rënë shitja e duhanit dhe askush nuk ka analizuar se sa do të rritet apo do të kushtojë trajtimi i të sëmurave me kancer brenda, si dhe jashtë vendit, të shkaktuar nga pirja e duhanit.

Faton Topalli – Unë jam megjithatë për të mos i injoruar kërkesat e qytetarëve, mirëpo konsideroj se si Komision, të marrim një qëndrim që të shtyjme deklarin, pasi që jemi edhe në fund të legjislaturës, sepse na duhet më shumë kohë që të analizojmë këtë çështje.

Time Kadriaj – Tha se jam për, pra që t'i japim dritën jeshile që të shkojë projektligji në seancë, mandej le të vendosë seanca se a do ta përkrahë këtë amendament apo jo.

Flora Brovina – Kryesia ka kërkuar rekomandim nga Komisioni lidhur me këtë nismë për ndryshimin e ligjit. Si Komision, duhet të vendosim se a do ta përkrahim apo jo. Unë jam që të mos ekspozohet duhani, pasi që mund të ketë pasoja, sepse nëse shkon një grua dhe e sheh të ekspozuar duhanin, mund të marrë një pako dhe të provojë dhe kështu mund të fillojë me konsumimin e duhanit.

Fikrim Damka – Po ua rikujtoj, si Komision, gjatë shqyrtimit të Ligjit për kontrollin e duhanit, kemi propozuar amendament, pikërisht për këtë çështje, i cili nuk ka kaluar në seancë. Tash të njëjtin propozim-amendament e kemi nga nisma për ndryshimin e Ligjit për kontrollin e duhanit. Ne jemi duke e votuar në parim për lexim të parë në seancë, do të ketë debat, dhe po ashtu, kur të vijë në Komision për shqyrtim, ne mund të ndërhyjmë, mund të shkojë pa përkrahjen e Komisionit për lexim të dytë. Kështu që ne duhet të vendosim për procedim në seancë, mandej seanca vendos.

Komisioni, pas diskutimeve, me 5 vota për, 4 kundër, përkrahu miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit.

5. Të ndryshme

Kryesuesi – Si Komision, kemi kërkuar nga ministri i Ministrisë së Shëndetësisë një raport lidhur me zbatimin e Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë, ku përmes kësaj shkrese ministri ka paraqitur masat apo veprimet që i kanë ndërmarrë për zbatimin e këtij ligji.

Nazane Breca – Unë e kam lexuar shkresën e Ministrit. Të dhënat që i kemi nga Oda dhe të dhënat që janë prezantuar këtu, ndryshojnë. Propozoj që në një nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit, t'i ftojme në mbledhje të Komisionit, ministrin dhe kryetarin e Odës së Mjekëve dhe të diskutojmë për zbatimin e ligjit.

Fikrim Damka – E përkrah këtë propozim dhe për së afërmi të diskutojmë lidhur me zbatimin e ligjit.

Salihe Mustafa – Kërkoj që të diskutojmë lidhur me Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale, i cili është miratuar në seancën e fundit. Pasi që si Komision kemi propozuar disa amendamente dhe i kemi përkrahur disa amendamente të deputetit Shaip Muja, kurse gjatë votimit të amendamenteve në seancë, deputetët nuk i kanë votuar amendamentet e deputetit Shaip Muja, mendoj se tash ligji është i mangët dhe do të ketë vështirësi gjatë zbatimit. Kërkoj që të diskutojmë si Komision, se a mund të bëjmë diçka që ligji të kthehet përsëri.

Fikrim Damka – Si Komision, nuk mund të bëjmë asgjë, pasi që ligji ka kaluar dhe është miratuar nga Kuvendi. Ne në seancë kemi paraqitur qëndrimin tonë se mosmiratimi i këtyre amendamenteve do të ketë pasoja në të ardhmen gjatë zbatimit të ligjit, mirëpo ministri i Shëndetësisë kërkoi që edhe në këtë formë të miratohet ligji, kështu që ligji ka kaluar, mbetet të shihet sa do të zbatohet.

Flora Brovina – Tha se si Komision, kemi një ftesë për vizitë nga Klinika e Kardiokirurgjisë Invazive, kështu që unë propozoj që të realizojmë një vizitë si Komision, në këtë klinikë.

Komisioni u pajtua që në javën e ardhshme, më 23.4.2014, t'i vizitojë dy institucione shëndetësore, Klinikën e Kardiokirurgjisë Invazive, si dhe Qendrën e Emergjencës.

Kryesuesi – Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka